



SHOQATA KOMBËTARE E GRUAS PROFESIONISTE, AFARISTE DHE ZEJTARE

Buletin Informativ

Tetor 2018

NË KËTË NUMËR

Informaliteti në turizmin bregdetar

Editorial

A u ul informaliteti në sektorin e turizmit bregdetar gjatë sezonit të fundit turistik?

Nga Drejtorja e Përgjithshme e Tatimeve raportohet se nga

9,486 kontrole të kryera në biznese gjatë sezonit të fundit turistik, 3,500 janë konstatuar me shkelje të ndryshme, pra rreth 37%.

Pra konstatohet se informaliteti vazhdon të jetë mjaft i lartë dhe duke pasur parasysh se krahas bizneseve të rregjistruara e që u kontrolluan nga 2-3 herë në muaj, pati mjaft biznese të tjera që as nuk ishin të regjistruara fare në tatime dhe që nuk iu nënshtruan asnjë kontrolli apo hetimi tatimor. Pra vazhdon abuziviteti dhe kontrolli klientelist tek bizneset.



Nga një analizë e shpejtë rezulton se ky informalitet i lartë vjen edhe për vetë barrën e lartë fiskale ndaj bizneseve dhe të një sistemi mjaft të ndërlikuar të tatimeve e taksave.

Ndaj u kërkojmë politikbërësve që të shkoni drejt një sistemi të thjeshtë të tatimeve e

taksave sidomos për biznesin e vogël e familjar e të mos i rëndoni me taksë të fshehta e indirekte apo me gjoha vend e pavend.

Një sistem i thjeshtë dhe i barabartë për të ardhurat tatimore si për bizneset e vogla ashtu edhe për individët duhet të rishikohet e të shkohet drejt **një barre fiskale të ndershme e të barabartë për të gjithë.**

Java Evropiane e SME-ve


Në kuadër të Javës Evropiane të SME-ve projekti 'Aftësi për Punë' S4J njofton se do të organizojnë edicionin e dytë të 'Javës për Praktikën Profesionale'! F2



Tkurret kredia për biznesin në 3/m tretë 2018

Sipas Bankës së Shqipërisë kredia për biznesin është tkurrur gjatë 3/m III 2018.

Faqe 3



Projekti BE “Rritje kapacitete të OSHC për shkrim projektsh në Kosovë”

Më datat 24-25 tetor 2018, në Prishtinë u organizua trainimi dy ditorë, për menaxherët dhe administratorët e organizatave të grave, rinisë, komuniteteve, rrjeteve dhe asociacioneve me temën për shkrim projektsh të BE-së dhe nacionale. Trainimi organizohej nga Prishtina REA dhe ishte e ftuar për të drejtuar edhe presidentja e SHGPAZ znj.Flutura Xhabija.



Java Evropiane e Aftësive Profesionale



Projektit '[Aftësi për Punë' S4J](#) Njofton se nga data 5 deri më 9 nëntor 2018, institucionet ofruese të Arsimit dhe Formimit Profesional, partnere të projektit '[Aftësi për Punë' S4J](#), do të organizojnë ***edicionin e dytë të 'Javës për Praktikave Profesionale'!*** Intervista për Praktikave Profesionale në biznes, diskutime të hapura, konferenca, vizita në kompani, histori suksesi të praktikantëve dhe sipërmarrësve, shkëmbim i përvojave mes mësuesve, prindërve dhe nxënësve janë disa prej aktiviteteve që do të organizohen gjatë kësaj jave ***në 5 qarqe të Shqipërisë: Shkodër, Lezhë, Tiranë, Berat dhe Vlorë.***

Bankat dhe biznesi


Tkurret kredia për biznesin në 3/m tretë 2018

Nga Tefta Demeti

Sipas Bankës së Shqipërisë, performanca e kredisë për SME në tremujorin e tretë të vitit 2018 ka qenë e dobët. Portofoli i kredisë së bankave për këtë segment është ulur me 0.5 miliardë lekë krahasuar me

tremujorin e dytë, ose 5.7% më pak se një vit më parë. Në këtë tkurrje ndikimin më të madh e dha kredia për biznesin e mesëm. Rënia e financimit për SME-të ka reflektuar si reduktimin e kërkesës për financim pranë bankave ashtu edhe kushtet e shtrënguara të bankave në këtë tremujor, sikurse konfirmohet nga rezultatet e vrojtimit të aktivitetit kreditues për tremujorin e tretë. Kërkesa më e pakët nga SME është ndikuar si nga gjendja më e mirë e likuiditetit të tyre në linjë me prurjet sezonale turistike, ashtu edhe nga mungesa e planeve për të bërë investime. Ndikim ka patur dhe rënia e besimit të bizneseve dhe perceptimi i tyre për situatën e përgjithshme makro. Ndërkohë, sipas vrojtimit bankat kanë shtrënguar kushtet e kreditimit për këtë segment, të cila janë ndikuar nga rreziku i sektorit, perceptimi bankës për rrezikun e kolateralit, toleranca e ulët e bankave për të marrë përsipër rrezik si dhe struktura e

bilancit të bankave. Gjithashtu, kërkesat rregullative të aplikuara që në fillim të vitit për dhënien e kredisë bazuar në bilancet fiskale




edhe për këtë segment, mendohet se kanë ndikuar si në kërkesën për financim ashtu edhe kushtet e kreditimit për këto biznese.

Gjatë tremujorit të tretë, vihet re se kredia për SME ka reflektuar rënien më të lartë të kredisë në lekë për këtë grup, ndërkohë që kredia në valutë ka shfaqur një rënie më të lehtë. Tkurrja vjetore kredisë në lekë me 7.8% është reflektuar në rënie të peshës së kredisë në lekë ndaj totalit në 44.5% përkundrejt 45.3% që shënonte në muajin qershor. Ndërkohë, kredia në valutë u tkurr me norma më të ulët vjetore, me 3.1% dhe pesha që zë ndaj kredisë

totale për SME është rritur me 1.1 krahasuar me shtator 2017. Zhvillimet e portofolit të kredisë për SME dëshmojnë që zhvendosja e portofolit të kredisë drejt lekut ka ndalur.

Sipas afatit të maturimit vihet re se tkurrja e kredisë për SME në terma vjetorë është ndikuar si nga rënia e kredisë afatshkurtër (-6.6%) ashtu dhe asaj afatgjatë me (-6.1%), ndërkohë që kredia afatmesme ka shfaqur një normë më të moderuar tkurrje (-3%). Struktura e kredisë sipas afatit të maturimit dominohet nga kredia afatgjatë me rreth 53.2%, por krahasuar me një vit më parë ajo është ulur me 0.2pp. Në krahasim me një vit më parë, në rritje është shfaqur kredia afatmesme, e cila shënoi një peshë prej 18.6% ndaj totalit të kredisë për SME ose 0.5 pp më lart se një vit më parë.

Gjithsesi duhet pranuar që kjo ecuri reflekton edhe mbiçmimin e fortë të lekut ndaj monedhës së përbashkët evropiane. Dhe dominimi i këtij portofoli nga kredia në valutë, kryesisht euro, tejçon një ndikim të rëndësishëm në vlerësimin e portofolit në fund të qershorit.



Biznesi Social vs. Ndërmarrje Sociale

Nga Tefta Demeti

Koncepti i një biznesi social nuk është i ri, por ka ekzistuar kohë më parë dhe vitet e fundit është ringjallur nga puna e Muhamed Yunus dhe të tjerët. Edhe në BE diskutohet për biznes social apo ndërmarrje sociale. Strategjia "Europa 2020": kërkon të promovojë një qasje të integruar për "një rritje të shpejtë, të qëndrueshme dhe përfshirëse", brenda një vizioni të përgjithshëm të një ekonomie sociale të tregut. Ekonomia sociale në BE punëson mbi 6% të punësimit total. Por çfarë kuptohet me Biznes Social?

Biznesi i shërbimeve/produkteve sociale ose shërbimet tek personat vulnerable (kujdesi shëndetësor, ndaj të moshuarve, të vegjëlve, të sëmurëve, invalidëve etj.) Biznese prodhuese të të mirave materiale/shërbime me objektiv social (integrimi social e profesional nëpërmjet punësimit të shtresave të disavantuazhara).

	Spektori publik	Spektori charity	Spektori privat
Logjika insitucionale	Demokracia kolektive	Perfitime sociale	Maksimizimi i fitimit
pronesia	kolektive	I dyanshem	private
perfituesit	publiku	kljentet	pronaret
Fokusi strategjik	Sherbimi publik	Krijimi i vlerave sociale	Krijimi i vlerave financiare
pergjegjesia	Flete votimi	Zeri stakholderve	Publikimi i performances financiare
Burimi Strategjik	taksat	Donacionet, grantet, te ardhurat e fituara, pagesa vullnetare, investime sociale	Kredi, ekuity, te ardhurat e fituara
Strukturat organizative	Burokracia administartive	charity	Kompanite private

Edhe në Shqipëri ka pasur një debat për biznesin social apo ndërmarrjet sociale dhe që në vitet 2011-2012 u bë e mundur hapja e Yunus Albania, aktiviteti i të cilit ka ardhur duke u konsoliduar çdo vit dhe tani ka mbështetur në mënyrë të sukseshme idetë inovative sociale bazuar në parimet e një biznesi social. Grantet që kanë përfituar bizneset e reja sociale në Shqipëri arrijnë deri në 1,5 milion USD.

Ndërsa transformimi i OJF në ndërmarrjeve sociale, po bëhet e mundur vetëm në vitin 2018-2019, në kuadër të implementimit të ligjit të ri 65/2016 "Për ndërmarrjet sociale", i cili edhe pse është miratuar që në vitin 2016 ende nuk ka filluar zbatimi e pritët që të fillojë gjatë vitit 2019. Pra edhe nga ky fakt del epërsia e biznesit social ndaj ndërmarrjes sociale.

Dita e të moshuarve 1 Tetor



1 tetori është Dita e të Moshuarve dhe në këtë ditë Shoqëria Shqiptare për të Gjitha Moshat, ASAG, me presidente Mira Pirdeni organizuan një sërë aktiviteteve sensibilizuese për një vemëndje ndaj kësaj shtrese të popullatës si dhe për një moshim aktiv.

ASAG gjithashtu festoi 19 vjetorin e krijimit të saj dhe prandaj SHGPAZ i uron suksese të mëtejshme në misionin e saj historik.

Restorant artizanat, në Dibër-Maqedoni

Nga Flutura Xhabija

Data 18 tetor 2018. Maqedoni, 15 minuta nga Dibra e Madhe, ndodhet një fshat me emrin Jançe(Jani), fshat i varfër duket, por me njerëz të mirë, myslimanë e ortodoks. Edhe pse nuk dinë shqip (por edhe kanë frikë të flasin- 70 vjet me frikë) por janë shqiptarë; dhe indirekt të thonë që kanë shumë kushërinj në Shqipëri, krejt shqiptare, pa asnjë përzierje; (keto i di më mirë gazetari hulumtues, fantastik, Marin Mema. Natën e fundit të llixhave miku im, shume i zgjuar dhe i dashur, Fisniku (bashkë me Artën, bashkëshorten) më shkruan që bëju gati se do të vij të marri atje, për të shkuar në një lokal të veçantë. U nisëm dhe sapo hymë në fshat më shpjegon për pronarin e këtij mjedisi: quhet Tefik Tefikovski, lindur e rritur në fshatin Jançe, por emigruar në Egjipt, nga i jati, për të hapur një restorant në Aleksandri; pastaj 15 vjet më vonë, pasi u mëkëmben mirë, u nisën (tashmë me tre femijë të rritur) për në veri të Italisë, për të hapur hotel e restorant me kuzhinë speciale ballkanike (e pak arabe sigurisht).

Tefiku iu bë krah të jatit, madje ia kaloi, dhe biznesi për 15 vjet të tjera i shkoi për mrekulli; por atij i rrinte mendja tek fshati i tij i lindjes dhe pasi shiti biznesin, hapi lokalin ku Ne shkuam. Aty shihje vetëm antikuare, sende e produkte origjinale fshati, rurale dhe artizanale. Edhe pse vjeshtë atje vendodhja ishte kaq origjinale sa lumi rridhte i qetë, nën këtë restorant/hotel, ndërsa brenda, burimit të ujrave malore, nuk ia kishin ndërprerë kalimin, përkundrazi një mundësi të rrjedhjes së tyre natyrshëm. Kjo ishte përshtypja e parë, pastaj i mora me rradhë fotot personale të varura në mur, raftet e sirtaret antike, tavolinat me specia të tharë, mbulesa me punime me dorë dhe objekte nga më të voglat deri tek të mëdhatë, mjaft interesante; me një fjalë, një muze origjinal.

Pronari ishte një burrë simpatik, i qeshur dhe i thjeshtë, i ditur dhe energjik, me plane të mëdha për të ardhmen dhe miqësi të madhe me shqiptarët (ai vete ishte shqiptar, por nuk e thoshte me gojen e tij 😊).

Biseda, në italisht me të, rrodhi shpejt, pa parë orën, por kënaqësia ime ishte se takova një biznesmen me aftësi të jashtëzakonshme dhe një përkushtim për traditën dhe trashëgiminë! Shijen e ketij takimi e kam edhe tani! Të qoftë puna e mbare, Tefik djali, sepse genet (sidomos iliro-shqiptare)



shpërthejnë në çdo kohë, në çdo vend e me koeficient të lartë! 🙌

Dita ndërkombëtare e vajzave

11 tetor 2018. Në Ditën Ndërkombëtare të Vajzave, UN Women organizoi mjaft takime interesante me moton:



"Bashkohuni për të festuar me vajzat që frymezojnë, bëjnë inovacion dhe marrin në dorë të ardhmen e tyre, kudo ku ato ndodhen". Vajza, ju mund të bëni gjithçka! 🌹



Paketa fiskale 2019

nga **Violeta Shqalsi**

Ministria e Financave do të nisë konsultimet me biznesin lidhur me paketën fiskale të vitit 2019. Bizneseve u janë dërguar pikat kryesore të drafteve që pritet të rishikohen. Ndër ndryshimet më të rëndësishme janë ulja e dividendit (aktualisht është 15%), dhe rishikimi i kufijve të pagës. Pagat mbi 130 mijë lekë sot taten mbi 23%, shifër kjo **më e larta në rajon**, e cila ka krijuar skema shmangieje për ata që kanë pagat e larta. Ndryshime të tjera janë norma e reduktuar TVSH 10 % për importin e autobusëve elektrikë të transportit publik, rregullimi i taksimit për personat fizikë tregtar; përjashtimi nga TVSH i furnizimit me shërbim nga nënkontraktorët për kontraktorët në industrinë fason etj.

Taksat. Në draftin e dërguar bizneseve për diskutim, mësohet se një ndër pikat e diskutimit do të jetë Ligji "Për Procedurat Tatimore". Këtu synohet një dispozitë antishmangie e përgjithshme, me qëllim mos-keqpërdorimin e ligjit për përfitime të pandershme fiskale. Qeveria kërkon reduktimin e mundësive për planifikim tatimor agresiv. Ndërkohë, parashikohen dispozita shtesë në legjislacion për taksimin e fitimeve kapitale në lidhje me aktive dhe të drejta që ndodhen në Shqipëri dhe që zotërohen nga jorezidentë shqiptarë, në lidhje me shitjet e kuotave të kompanive, aktiveve

apo të drejtave që ndodhen në Shqipëri. Një tjetër pikë diskutimi këtu është rregullimi i taksimit për personat fizikë tregtarë.

"Dizenjimi i një skeme që takson të ardhurat pas tatimit (0 % për 5 milionë, 5 % për 5-14 milionë dhe 15 % për mbi 14 milionë). Kjo pasi barra fiskale e një personi fizik është minimalisht 13 % më e ulët se e një investitori në kapital, 6-7 % më e ulët se e një të punësuarit dhe maksimalisht pa taksë", thuhet në draft.

Ligji i TVSH. Në ligjin për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar, parashikohet përjashtimi në import i lëndëve të para për fabrikat e prodhimit farmaceutik; përjashtimi nga TVSH i furnizimit me shërbim nga nënkontraktorët për kontraktorët në industrinë fason; përjashtimi nga TVSH i importit të makinerive bujqësore sipas listës së miratuar me VKM, nga çdo importues; si dhe normë e reduktuar TVSH 10 % për importin e autobusëve elektrike të transportit publik.

Ligji për akcizat. Në paketën fiskale 2019, qeveria po planifikon dhe rishikim të akcizës për rërat dhe zhavorret bituminoze, duke taksuar atë lloj lënde të parë që zëvendëson nënproduktet e naftës dhe ndikon në ambient. Po ashtu, parashikohet heqja e akcizës për fishekzjarret, llambat, pilat/bateritë, si dhe rishikimi i nivelit të akcizës për duhanin e përpunuar dhe zëvendësuesit e tij, duhanet me ngrohje, purot.



Tatimi mbi të ardhurat. Në ligjin për Tatimin mbi të Ardhurat, është planifikuar të rishikohet norma e tatimit mbi dividendin. Po ashtu, një tjetër rishikim do ketë dhe për kufijtë e pagës që taten me norma të ndryshme tatimore. Shqipëria mban rekord në rajon për taksimin e Individëve me paga të larta. Norma progresive prej 23%, për pagat mbi 130 mijë lekë (rreth 930 euro) është unike në gjithë rajonin, që i taton të ardhurat nga paga mesatarisht me 9-11%. Për krahasim, Mali i Zi, që paga të larta kategorizon ato mbi 720 euro neto, i taton me 11%, nga 9% që taten pagat nën këtë nivel.

Ligji "Për taksat Nacionale". Në ligjin për taksat nacionale parashikohet të ndërhyhet në ndryshimin e skemës së taksimit të ambalazheve plastike, ku synohet kalimi nga taksimi i ambalazheve plastike, tek taksimi i materialeve plastike, duke e ulur me 2/3 normën ekzistuese. Po ashtu, axhustime parashikohen dhe në skemën e rentës minerare për industrinë e kromit, me qëllim nxitjen e përpunimit brenda vendit të mineraleve duke shtuar vlerën e tij për eksport.

FAKTE

29.7%

Biznese aktive të drejtuar/pronare gra, për vitin 2017 në Shqipëri rezultojnë 29.7% me një ritje prej 2.9 pikë % krahasuar me 2016, por me një rënie me 1.6 pikë % në krahasim me vitin 2015 ku përbënin 31.3%. (INSTAT)



3.2%

Kredia për vitin 2017 rezulton me një rritje modeste me vetëm 3.2% krahasuar me një vit më parë dhe zë 36,5% ndaj PPB, me një ulje prej 1 pikë përqindje krahasuar me 2016. (Banka e Shqipërisë)



Anëtarët e SHGPAZ punojnë e festojnë

Foto nga pjesëmarrëset në festimin e ditëlindjes së një prej anëtareve të SHGPAZ, më 19 tetor 2018 në Pogradec. Natyrisht organizimi u realizua nga presidentja e SHGPAZ, znj.Flutra Xhabija.



Dokumentar për sipërmarrëset e SHGPAZ

Në kuadër të promovimit të eksperiencave pozitive të Sipërmarrjes femërore në Shqipëri një grup xhirimi italian erdhi pranë zyrave të SHGPAZ ku Presidentja e SHGPAZ, znj.Flutura Xhabija u intervistua për punën e palodhur mbi 25 vjeçare në mbështetje të sipërmarrjes femërore në Shqipëri, si dhe u vizitua sipërmarrësja e suksesëshme që drejton qendristarinë Agia.



Gruaja dhe shëndeti

Rënia e dëgjimit dhe parandalimi i tij

Materiale të përpunuara nga **Arlinda Demeti**

Dëgjimi është një proces ndijor rezultat i një aktiviteti të sinkronizuar të një serë organesh dhe qelizash. Organi kryesor i shqisës së të dëgjuarit është **veshi**. Tek veshi i njeriut, në sajë të funksionit që kryhet, dallojmë veshin e jashtëm, veshin e mesëm dhe veshin e brendshëm. Nëse njeriu është i aftë të shquajë një repertor të gjërë tingujsh dhe të prodhojë imazhe sonore, kjo realizohet në sajë të pranisë së një kategorie qelizash të specializuara të pozicionuara në zonën e veshit të brendshëm. Ngacmuesit që ndikojnë në të dëgjuarit tonë janë valët zanore që konsiderohen si ndryshime të shpeshta në presionin e ajrit të shkaktuara nga një objekt vibrues, si kordat vokale në kontakt me ajrin.

Rënia apo humbja e dëgjimit ka shkaktarë të shumtë si përdorimi i gabuar i disa medikamenteve, trajtimi jo i përshtatshëm i infeksioneve të veshit, si dhe gjendjeve gripale, zhurmat e forta, konsumi i lartë i duhanit, anemia etj. Këta faktorë rrisin rrezikun shkaktues për qëndrueshmëri të madhe të çrregullimeve të dëgjimit, për të cilat nëse merret kujdesi i duhur, mund të parandalohen efektet e tyre negative. Natyrisht që me rritjen e moshës dobësohet edhe nervi i dëgjimit, ashtu si i gjithë organizmi. Pra ne nuk jemi në gjendje të parandalojmë dëmtimin fiziologjik të humbjes

së dëgjimit, por kemi mundësi ta vonojmë atë, duke marrë



tepër kanalën. Kështu, nuk janë të pakta rastet në të cilat përdorimi i mjeteve të

masat e duhura parandaluese. Zakonisht rënia fiziologjike e dëgjimit fillon pas moshës 70 vjeç.

Dylli i veshit. Por, organizmi ynë ka edhe masat e veta mbrojtëse për ruajtjen e organit të veshit. Trupi prodhon dyllin e veshit (cerumen) për të pastruar dhe mbrojtur veshët. Dylli mbledh papastërtitë, pluhurat dhe lëndë të tjera dhe i nxjerr ato jashtë tij, duke ndihmuar kështu në parandalimin e infeksioneve të ndryshme. Për shumë njerëz dylli i veshit është një tregues i papastërtisë dhe kanë tendencë ta pastrojnë atë më çdo kusht. Ky keqinformim çon në zakone të pasigurta shëndetësore.

Aktivitetet e përditshme, siç janë: lëvizjet e nifullave gjatë përtypjes, apo të folurit, bëjnë që dylli i veshit të rrjedhë normalisht në drejtim të vrimës së jashtme të veshit, gjë e cila pastrohet lehtë gjatë larjes. Ky është një proces normal i vazhdueshëm, por nganjëherë, ky proces vetëpastrimi mund të dështojë. Si rezultat, dylli mund të bllokohet pjesërisht, ose plotësisht kanalën e veshit.

Jo rrallë pacientët mendojnë se kur kanë probleme me dëgjimin, u janë bllokuar veshët nga dylli dhe tentojnë t'i pastrojnë ato me kunga apo mjete të tjera të forta. Kjo përpjeke për të eliminuar dyllin e veshit krijon probleme të mëtejshme duke e shtyrë më thellë dhe duke e bllokuar më

forta, mund të çojë në dëmtimin e membranës së veshit. Përveç kësaj, mund të shkaktohen dëmtime përgjatë kanalit, të cilat shoqërohen me humbje të dëgjimit, apo marrje mendsh. Ndaj është e rekomandueshme që gjatë larjes, veshët të pastrohen aq sa lejon futja e gishtit të vogël në to. Po ashtu duhet të thahen në të njëjtën mënyrë me peshqir. Asnjëherë nuk duhet të bëhet pastrimi i thellë i veshëve qoftë edhe me kunga e pambukut.

Parandalimi

Marrja e masave të duhura kundrejt monitorimit të faktorëve të rrezikut, vonon shfaqjen e çrregullimeve të dëgjimit. Sipas të dhënave të raportuara nga strukturat e shëndetit, pjesa dërrmuese e çrregullimeve të dëgjimit mund të parandalohen, nëse veprohet herët ndaj tyre. Një ndër ndërhyrjet më të mira është edhe vaksinimi i detyrueshëm kundër fruthit, rubeolës, parotitit, për të zvogëluar infeksionet e lindura, imunizimet kundër gripit dhe sëmundjet pneumoniane për të reduktuar rastet me infeksion të veshit të mesëm. Duhet të shmangni sa më shumë që të jetë e mundur edhe zhurmat e forta, si dhe të trajtoni në kohë infeksionet gripale dhe ato të veshit. Përdorimi i medikamenteve duhet të bëhet vetëm me rekomandim të mjekut specialist.

KALENDARI I AKTIVITETEVE I PERDITESUAR TETOR-DHJETOR 2018		
DATAT	VENDI KU ZHVILLOHET	TEMATIKA
TETOR		
1 tetor 2018	Tiranë, shoqata ASAG	NDERVEPRIM MOSHOR
4 tetor 2018	Tiranë, hotel Tirana	Ministria e Financave dhe Ekonomisë
03-05 tetor 2018	Kabul, Afganistan	Edicioni i 21-të i Panairit Ndërkombëtar të Bujqësisë.
10-12 tetor 2018	Lisbonë	Takim grash të biznesit
17-19 tetor 2018	Prishtinë	Panairi ndërkombëtar i agrobiznesit "AGROKOS 2018", 20 vende të ndryshme, sektori i bujqësisë, hapjen e tregjeve të reja, promovimin e produkteve & shërbimeve në këtë sektor
17 tetor 2018	Split, Kroaci	Dhomat e Adriatikut dhe Jonit
24-27 tetor 2018	Tiranë	Takim me gra sipërmarrëse bullgare
22 tetor 2018	Moskë	FCEM-shoqata nderkombëtare e grave sipërmarrëse
23-24 tetor 2018	Milano ekspozite	me konkurs, kush ka produktin e pranuar nga organizatori
NENTOR		
3-4 nentor 2018	Strasburg, Francë Palace of Congresses	International forum-exhibition "Hands of women" with the participation of masters in field of decorative & applied art from 85 regions of Russia, CIS countries, Europe & Asia.
18-23 nentor 2018	Graz, Austri	Asambleja e SME-ve, nga Brukseli, EU
21-24 nëntor 2018	Stamboll, Panairi i 17-të MÜSIAD	Shpenzimet e akomodimit në Stamboll dhe transportit të brendshëm, për kompanitë pjesëmarrëse do të paguhet nga ana e organizatorëve, që operojnë në sektorë si : High-Tech Port, Ushqim, Bujqësi, Blegtori, Energji, Miniera, Automobilistikë, Plastikë, Ndërtim dhe Materialeve të Ndërtimit, Mobilieri, Turizëm, Shëndetësi, Teknologji Informacioni, Logjistikë, Shërbime..
21-25 nëntor 2018	Algjeri	Salloni Ndërkombëtar i Punëve Publike; synon të konsolidojë marrëdhëniet ekonomike midis Algjerisë dhe vendeve partnere për promovimin e mundësive për investime dhe partneritet në fushën e Punëve Publike. për informacion mund të gjeni në www.safex.dz
DHJETOR		
4 dhjetor 2018	Paris, Francë	Paris, konference inovatoret dhe inovacioni
22 dhjetor 2018	Lezhë	Lezhë festa e vitit të ri për SHGPAZ

Një sipërmarrëse shqiptare në mes të Athinës

Nga Flutura Xhabija

Athinë, 1 tetor 2018. E gjeta një sipërmarrëse të vërtetë në Athinë 🙏 Nuk e besoni 😊, shikojeni në foto; sot në mesditë, në mes të kryeqytetit grek, në një nga lagjet më të mira të saj 🏡. E quajnë Meno Karteri (mbesa e Mamicës sonë), ka pesë vjet që e ka hapur biznesin e saj bashkë me një ukrainase. Ajo ka dy femijë të rritur, vajzën me diplomë në turizëm dhe djalin në gjimnaz, por ia doli e ia del e vetme në familje. Meno pasi punoi tek një pronar grek në një fasfood, kërkoi që të mos ia ulte pagën, ai nuk pranoi dhe menjëherë ajo hapi biznesin e vet, madje erdhi gjithë stafi me këtë vajzë (për mua vajzë është, 39 vjeçe) inteligjente dhe e guximshme.

Meno di shumë mirë gjuhën greke, mirësjelljen dhe disiplinën, ligjet dhe të drejtat e saj. Sa për recetat e ushqimit, te klientela, te shërbimet e reja e të rritjes së biznesit, për të përballuar konkurrencën, është e rrallë. Mendoni një grua, një nënë dhe një sipërmarrëse në një vend të huaj, pa ndihmën e askujt 🙌🙌 Edhe ky është një shembull i shkëlqyer i vullnetit, dëshirës, kurajos dhe vetëbesimit se askush nuk "e nxjerr veshgjatin" nga balta, vetëm i zoti i tij! Ishte kënaqësi që të takova Zonja Meno dhe ec përpara se Puna (fizike dhe mendore) nderon e prosperon secilin prej nesh!



Buletin
Informativ

Tetor 2018

Rr.Mujo Ulqinaku,
Pall.Kristian Konstruktion,
kati 1, ap.9 Tirana-Albania
phone/fax:00355 4 2235726
mob.0682763344, 0692572423
info.shgpaz@yahoo.com



Përgatiti

Msc. Flutura XHABIJA &
MBA. Tefta DEMETI